

ABSTRAKTI

Larja e parave është formë mjaft e përhapur e krimit të jakës së bardhë në vendet e shoqërisë bashkëkohore, e veçmas në vendet në tranzicion. Si rrjedhojë, të gjitha shtetet kanë ndërmarrë hapa konkret për ta parandaluar dhe luftuar këtë dukuri. Kosova poashtu, ka ndërmarrë masa konkrete duke inkriminuar larjen e parave si vepër penale përmes dispozitave të Kodit Penal, por edhe duke nxjerrë ligje të veçanta siç është Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, me të cilin është themeluar edhe Njësia për Inteligjencë Financiare. Prandaj, qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë rolin e Njesisë për Inteligjencë Financiare (NJIF), në parandalimin dhe luftimin e larjes së parave në Kosovë nga viti 2017 deri në vitin 2021. Në këtë hulumtim është aplikuar metoda kualitative (deskriptive). Të dhënat janë mbledhur nga analizimi i Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe analizimi i raporteve të publikuara nga Njësia për Inteligjencë Financiare.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se kjo njësi ka ndërmarrë masa konkrete në përmbushjen e obligimeve të saj ligjore, përmes pranimit të një numri të konsiderueshëm të raportimeve për transaksione të dyshimta, raportimeve pranë Policisë së Kosovë në rastet e dyshuara për veprën penale “Shpërlarja e parave”, lëshimit të udhëzimeve për pezullim të përkohshëm të transaksioneve ose ngrirje të llogarive, bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë mes institucioneve dhe agjencitë e zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe partnerët e huaj për masat efektive të luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Fjalët kyçe: parandalimi dhe luftimi i larjes së parave, Njësia për Inteligjencë Financiare, legjislacioni